



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Ne kemi vërejtur në një rast se KQZ kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve në vlerë prej 103,230€. Pagesa ishte bërë nga kategoria investime kapitale e cila për nga natyra i takonte kategorisë mallra dhe shërbime. Këto mjete ishin të buxhetuara me rishikim të buxhetit Ligji nr.08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i KQZ-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i KQZ-së është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i KQZ-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me tri rekomandime, prej tyre dy janë rekomandime të reja dhe një rekomandim pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategorinë ekonomike

Gjetja Rregulla financiare nr. 01/2013/MF-Shpenzimi i parave publike, neni 18, pika 3 përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Po ashtu, UA 19/2009 për planin kontabël për përdorim nga organizatat buxhetore, neni 11 kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Në kontratën për modifikim/zhvillim të softverit të Qendrës së Numërimit të Rezultateve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, KQZ kishte bërë pagesën në vlerë 103,230€ nga kategoria ekonomike jo adekuate, investime kapitale (kodi ekonomik 31680- Softuer), përderisa këto shërbime/shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime. Kjo për arsye se për çdo organizim të zgjedhjeve është e nevojshme të bëhet modifikimi i softverit i cili nuk i shton vlerë dhe jetëgjatësi.

Kjo kishte ndodhur për shkak se këto shpenzime ishin buxhetuar në kategorinë investime kapitale.

Ndikimi Keq klasifikimi i buxhetit dhe pagesa e shpenzimeve nga kategoria ekonomike jo adekuate ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e shpenzimeve në kategoritë ekonomike përkatëse dhe si rrjedhojë prezantim jo i drejtë i të dhënave në Pasqyra Financiare Vjetore.

Rekomandimi A1 Kryetari i KQZ-së, të sigurojë se është bërë planifikimi i drejtë i buxhetit si dhe realizimi i pagesave të bëhet në kategoritë ekonomike të duhura, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në Pasqyra Financiare Vjetore sipas standardeve të kontabilitetit dhe në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 326,999€, pasurive jokatitale është 895,368€, si dhe e stoqeve 22,980€. Kemi testuar 8 mostra për teste substanciale në vlerë 161,704€, gjithashtu kemi aplikuar teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Sipas rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë, neni 4 paragrafi 3 ka përcaktuar se të gjithë zyrtarët e organizatës buxhetore janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë që është në posedim dhe për mbikëqyrje të tij kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të pa autorizuar të tyre sipas përgjegjësisë që i përfshin fushëveprimi i tij. Neni 6 paragrafi 2 ka definuar se regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale (vlera individuale mbi 1.000€ dhe afat të përdorimit më shumë se një vit), pasuritë jo kapitale (vlera individuale më e vogël se 1.000€ dhe afat të përdorimit më shumë se një vit) dhe stoqet;

- Gjatë testimit të pasurisë kemi vërejtur se në regjistrin e pasurisë SIMFK (pasuria mbi 1,000€) pajisja me emërtim “Llap Top DELL Latitude D400 1.6 ghz” me vlerë fillestare 1,960€ (vlera në libër zero) sipas përshkrimit të gjendjes së pasurisë e cila figuron se është në përdorim, mirëpo me ekzaminim fizik rezultojë se pajisja nuk ekziston. Po ashtu nuk kishte evidencë se kush e posedonte (në përdorim/shfrytëzim të cilit zyrtar ishte); dhe
- Modifikimi i softuerit të QNR-së dhe K-Vote për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vlerë 138,920€ (shpenzimet për Modifikim të Softuerit 103,230€, shpenzimet e IT 19,300€ dhe shpenzimet e internetit 15,760€) ishin regjistruar gabimisht në regjistrin kontabel të SIMFK-së. Modifikimi i softuerit të QNR-së dhe K-vote bëhet sa here të mbahen zgjedhjet dhe vlera investimeve nuk ka afat përdorimi më shumë se një vit, kjo do të thotë se vlera e pasurisë mbi 1,000€ është mbivlerësuar.

Në lidhje me mungesën fizike të laptopit zyrtarët përgjegjës na informuan, se pajisja është blerë në vitin 2004 dhe nuk kanë evidenca se ku gjendet dhe kush është ngarkuar me të. Regjistrimi i pasurive në SIMFK me jetë gjatësi me pak se një vit kishte ndodhur pasi që kjo blerje ishte buxhetuar si projekt kapital.

Ndikimi Kontrolllet e dobëta në menaxhimin e pasurisë kanë rezultuar me mangësi në këtë komponentë të cilat e rrisin rrezikun ndaj humbjeve apo keqpërdorimit të tyre. Ndërsa, regjistrimi në kategori të gabuara ndikon në pasqyrim jo të drejtë në PVF.

Rekomandimi A2 Kryetari i KQZ-së duhet të forcoj kontrollat brendshme në menaxhimin e pasurisë, në mënyrë që pasuritë të ruhen nga humbja dhe keqpërdorimi i tyre si dhe të bëhen regjistrimet në kodet e duhura në mënyrë që të sigurohet raportim i drejtë dhe i saktë i gjendjes së tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mos kalkulimi i zhvlerësimit të pasurisë jo financiare

Gjetja

Sipas rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë, neni 22 paragrafi 3 definon se të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Gjithashtu, neni 24 pika 3 thot që paraqitja e pasurisë jo financiare në Pasqyrat financiare vjetore do të prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto.

Për blerjet e pasurive jo kapitale (nën 1000 euro) gjatë vitit 2021 nuk ishte kalkuluar zhvlerësimi. Edhe pse kjo gjendje ishte shpalosur në shenimet e PVF-ve, pasuritë jo kapitale ishin pasqyruar në PVF me vlerën bruto të tyre. Më tej, KQZ nuk ka informata se sa ishte vlera e zhvlerësimit të këtyre pasurive për vitin 2021.

Mos kalkulimi I i shpenzimeve të zhvlerësimit ishte rezultat i problemeve me sistemin E pasuria.

Ndikimi

Mos zhvlerësimi i pasurive ka ndikuar në mbivlerësimin e tyre dhe në prezantim jo të drejtë të gjendjes së pasurive në pasqyrat vjetore financiare.

Rekomandimi C1

Kryetari i KQZ-së duhet të ndërmerr masa të duhura për eliminimin e pengesave në menaxhimin e pasurive, në mënyrë që të siguroj raportim të drejtë të gjendjes së tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	13,923,404	16,796,516	16,435,543	5,853,964	10,690,593
Grante Qeveritare - Buxheti	13,923,404	16,794,940	16,435,543	5,853,964	10,690,593
Donacionet e jashtme	0	1,577	0	0	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,873,112€. Buxheti fillestar është rritur 165,850€ me vendim të Qeverisë sipas kërkesës për buxhet shtesë për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Me rishikim të buxhetit ka pasur rritje në vlerë 3,860,725€ për zgjedhjet e rregullta lokale. Ndërsa me deklaram të kursimeve buxhetore është zvogëluar buxheti final në vlerë 1,084,282€.

Në vitin 2021 KQZ ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 16,435,543€. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	13,923,404	16,796,516	16,435,543	5,853,964	10,690,593
Pagat dhe mëditjet	1,109,704	1,204,797	1,204,797	1,051,492	1,245,184
Mallrat dhe shërbimet	8,550,000	11,151,046	10,873,252	563,593	5,219,921
Komunalitë	63,700	160,750	77,570	13,439	11,993
Subvencionet dhe transferet	4,200,000	4,173,094	4,173,094	4,177,307	4,064,149
Investimet Kapitale	0	106,830	106,830	48,133	149,346

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur me vendim të Qeverisë nr.11/52 të dt. 29.12.2021 në vlerë 95,093€. Kjo rritje kishte të bënte me kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të rregullt të punës, si rezultat i mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe atyre të rregullta lokale;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime (pa donacione) në raport me buxhetin fillestar me rishikim të buxhetit ishte rritur në vlerë 2,599,469€. Kjo rritje ishte si rezultat i organizimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe zgjedhjeve të rregullta lokale. Gjithashtu në këtë kategori ka pasur zvogëlim në vlerë 14,800€ për transfere në kategorinë për shërbime komunale si dhe në fund të vitit si rezultat i shkurtimeve buxhetore, buxheti ishte zvogëluar në vlerë 925,512€;
- Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar ishte rritur në vlerë 97,050€. Prej tyre 22,250€ me Vendim të Qeverisë për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, dhe 14,800€ ishin transferuar nga kategoria mallra dhe shërbime si dhe 60,000€ me rishikim të buxhetit për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë fikse;
- Buxheti final për Subvencione dhe Transfere në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për vlerën 29,906€. Ky zvogëlim ishte rezultat i buxhetit të pa shpenzuar nga grupet parlamentare të legjistraturës para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare; dhe
- Buxheti final për Investime Kapitale ishte ndarë në vlerë 106,830€. KQZ në buxhetin fillestar nuk kishte buxhet të aprovuar për shpenzime kapitale. Mirëpo, për zgjedhjet e parakohshme parlamentare me vendimin e Qeverisë nr. 01/56 për projekte kapitale ishte ndarë buxhet në shumë prej 143,600€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga KQZ-ja në 2021 ishin në vlerë 45,291€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga bartja e depozitave të subjekteve politike, të hyra nga regjistrimi i subjekteve të reja politike si dhe të hyrat nga shqiptimi i gjobave për subjekte politike.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	45,291	2,400	27,974
Të hyrat jo tatimore	0	0	44,864	2,400	27,974
Të hyrat tjera	0	0	428		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 ka rezultuar në tri rekomandime. KQZ kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, dy rekomandime janë zbatuar; ndërsa një rekomandim ishte pjesërisht i adresuar (çështja e zhvlerësimit të pasurisë mbetet e pa zbatuar).

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve). (Vëni re se kur ceket fundi i auditimit, i referohemi fundit të procesit të auditimit - deri në momentin kur e dërgojmë raportin e këtij viti).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari i KQZ-së duhet të bëj me kohë planifikimin e nevojave dhe lidhjen e kontratave për këto furnizime, për të parandaluar pagesat e parregullta dhe të pa kontraktuara.	KQZ, ka ndermarr masa duke forcuar kontrollet në planifikimin e nevojave dhe lidhjen e kontratave për furnizime dhe si rezultta i këtyre masave gjatë vitit 2021 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla.	I zbatuar
2.	Pasuritë	Kryetari i KQZ-së duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke siguruar se zhvlerësimi i pasurisë po kalkullohet saktë. Po ashtu pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme.	Edhe në këtë vit kemi dobësi në menaxhimin e pasurive, çështja e zhvlerësimit të pasurisë mbetet e pa zbatuar.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari i KQZ-së duhet të ndërmerr masat e nevojshme që të sigurojë funksionimin e KA, i cili duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.	KQZ në vitin 2021 ka formuar komitetin e auditimit i cili ishte funksional.	I zbatuar


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Shemsije Llugiqi, Udhëheqëse e ekipit



Ganimete Dalloshi, Anëtare e ekipit



Mazlumsha Sejfadini, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Letër Konfirmim



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,



Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Prishtinë, më 07 qershor.2022



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.